



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 41/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shpresa Musliu, për shkak të anulimit të vendimit nr. V_949_2018 të datës 29.03.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 19.09.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 03.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V_949_2018 të datës 29.03.2018 të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V_949_2018 të datës 29.03.2018, si jo i ligjshëm, me arsyetimin se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se njehsori pllombat i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka dhe se njehsori në tabelën e të dhënave A2 është manipuluar me një thikë mirëpo komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi tjetër, andaj KES/CO ka konsideruar se shpenzimi dhe regjistrimi në njehsorin elektrik nr. 0442282 nga pranimi 25.10.2001 deri me datë 27.06.2016 (177 muaj) është 80,016 kWh të faturuar përmes faturave të rregullta mujore. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka shtuar se është fakti i ditur se konsumatorët shpenzojnë sipas dy strukturave, por për shkak se gjendja në A2 ka qenë e mbuluar me një tiketë andaj faturimi i shpenzimit për kv e shpenzuara nuk ishte bërë, për çfarë pas raportit nga qendra e kalibrimit, është bërë korrigjimi nga ana e paditësit. Gjithashtu ka theksuar se në momentin e tërheqjes së njehsorit gjendja në A2 ka qenë 45,270 kWh për çfarë mesatarja e shpenzimit nga dita e pranimit të njehsorit e

deri me 27.06.2016 në strukturën tarifore A1 ka qenë 196.3 kWh për muaj, ndërsa në tarifën A2 ka qenë 452 kWh për muaj e që është e përafërt me mesataren e shpenzimit me njehsorin e ri e që është 427 kWh për muaj, prandaj gjykatës i ka propozuar që të aprovet padia e paditësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i Bordit të ZRRE-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë pasi që njehsori elektrik i konsumatorit është pranuar teknikisht nga punëtorët e autorizuar për regjistrim të njehsorit elektrik të KEK me datë 25.10.2001 dhe se nga kjo periudhë konsumatori është faturuar në një tarifë të vetme dhe se në asnjë rast dhe asnjë procesverbal nuk është identifikuar çfarëdo vërejtje me të cilën do të kërkohej që të verifikohet njehsori elektrik. Po ashtu kanë theksuar se nga raporti i kontrollit është konstatuar vetëm se, në njehsor tabela me të dhëna teknike është e mbuluar me një tiketë në tarifën e dytë dhe nuk kanë vërejtur ndonjë parregullsi tjetër dhe se sipas këtij raporti nuk qëndron pretendimi i KES/CO se njehsori elektrik - tabela e të dhënave në A2 është manipuluar me një thikë. Gjithashtu kanë theksuar se kanë kërkuar nga këtu paditësi të ju dorëzohet procesverbali i verifikimit të njehsorit elektrik për të parë nga afër se shpenzimi i evidentuar në procesverbalin e verifikimit të qendrës së kalibrimit a është aktiv apo që nga fillimi ka qenë me atë shpenzim, por që paditësi nuk ju ka dorëzuar procesverbalin e shqyrtimit. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se operatori i sistemit është organ përgjegjës për të siguruar leximin e saktë dhe të rregullt të njehsorëve elektrik në përputhje me kodin e matjes dhe në këtë rast paditësi ka dështuar që të veproj në përputhje me obligimin e tij ligjor, andaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe Vendimi i Bordit të ZRRE-së të mbetet në fuqi.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim i ZRRE V_949_18 i datës 29.03.2018, Vendim i ZRRE, DMK_V_1754_01_18 i datës 22.01.2017, Formular i ankesës se konsumatorit 05.09.2016; Fatura për periudhën 07.2016 dhe 08.2016, Rrjedha e njësorit të energjisë aktive për periudhën 04.2003 - 04.2018, Procesverbal nr. 45/15 i datës 15.07.2016, Procesverbal nr. 627577 i datës 27.06.2016, Procesverbal nr. 1821644 i datës 02.06.2016, Raport i korigjimit për konsumatorin NTP FATI i datës 11.08.2016, Vendim i Kesko i datës 12.10.2016, Procesverbal nr. 461895 i datës 20.09.2016, Proces i datës 25.10.2001, Kundërshtim nga KESKO i datës 20.02.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me Vendimin e Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK-së) ZRRE/DMK_V_1754_01_18 të datës 22.01.2017, është aprovuar ankesa e konsumatorit A.A, dhe është obliguar KES/CO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90025040 nga korrigjimi nr. 87309DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 409.36€ dhe nr. 87310DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 2,749.28€, të datës 06.10.2016.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, të cilët me Vendimin V_949_2018 të datës 29.03.2018 kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e KES/CO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.A, me shifër të konsumatorit DPR – 90025040 dhe ka mbetur në fuqi vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1754_01_18 i datës 22.01.2017.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 15 par. 1, nën-par. 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: ... 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë;”* si dhe në kuptim të nenit 17 par. 1 që përcakton se: *“1. Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara;”*. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 14, 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr. 04/2017 e datës 16 mars 2017) që përcaktojnë kompetencën e DMK-së pranë ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga furnizuesi apo operatori i sistemit si dhe kompetencën e Bordit të ZRRE-së për vendosjen për ankesat ose kontestet ndaj vendimeve të DMK-së.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara. Gjykata nga prova Formular i ankesës së konsumatorit ka konstatuar se konsumatori A.A me datë 05.09.2016 ka parashtruar ankesë tek paditësi lidhur me kalkulimin e faturës dhe borxhit për pagesë dhe nga prova Vendim i

KES/CO i datës 12.10.2016 gjykata ka konstatuar se këtu paditësi ka refuzuar ankesën e konsumatorit.

Nga prova procesverbal nr. 1821644 i datës 27.06.2016 gjykata ka konstatuar se ekipa e paditësit tek konsumatori A.A ka konstatuar gjendjen e shpenzimet në tarifën A1 34,746 kWh dhe në tarifën A2 nuk kanë konstatuar ndonjë shpenzim dhe po ashtu është konstatuar se njehsori duhet ndërruar. Nga prova procesverbal nr. 627577 i datës 27.06.2016 gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe tek njehsori i vjetër nr. 04422828 kanë konstatuar shpenzimet në tarifën A1 34,746 kWh dhe në tarifën A2 nuk kanë konstatuar ndonjë shpenzim.

Nga prova e administruar procesverbal nr. 45/15 i datës 15.07.2016 gjykata ka konstatuar se Qendra e Kalibrimit ka bërë kontrollimin e njehsorit elektrik nr. 04422828 dhe kanë konstatuar se pllombat i ka në rregull, nga ana e jashtme nuk ka dëmtime dhe në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtur se tabela e të dhënave teknike është e mbuluar me një tiketë në tarifën e dytë dhe ka gjendje, mirëpo komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi tjetër.

Nga prova rrjedha e njësorit të energjisë aktive për periudhën 04.2003 - 04.2018, gjykata ka konstatuar se konsumatori A.A, në periudhën 04.2003 – 07.2016 nuk ka regjistruar ndonjë shpenzim në tarifën e ulët A2. Regjistrimet e shpenzimeve në këtë tarifë kanë filluar nga muaji 07/2016 pas ndërrimit të njehsorit.

Nga prova proces i datës 25.10.2001, gjykata ka konstatuar se me rastin e instalimit të njehsorit elektrik tek konsumatori A.A, ndër të tjera janë përshkruar këto shënime: njehsori elektrik nr. 04422828, tarifa e lartë TL: 00005/02736, tarifa e ulët TU: -.

Nga provat raport i korrigjimit për konsumatorin NTP FATI i datës 11.08.2016, gjykata ka konstatuar se KES/CO ka bërë korrigjimin e faturimit për konsumatorin duke vendosur obligimin shtesë për pagesë në shumë prej 3,158.64€.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me faktin se është obliguar KES/CO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90025040 nga korrigjimi nr. 87309DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 409.36€ dhe nr. 87310DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 2,749.28€, të datës 06.10.2016. Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë arsyetimin e ZRRE se nga prova proces i datës 25.10.2001 punëtorët e autorizuar të KEK kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik dhe kanë bërë evidentimin vetëm të njëjës tarifë dhe nuk kanë evidentuar se njehsori ka dy tarifa për faturim. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se të gjitha provat e

administruara në këtë çështje lidhur me gjendjen e shpenzimeve në tarifën A2 nuk kanë pasur shënime dhe rubrika e përcaktuar për të konstatuar këtë gjendje ka qenë e mbyllur me vijë të drejtë (--).

Gjykata vlerëson se një korigjim i tillë nga paditësi është në kundërshtim me nenin 29 në par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili përcakton se: *“1. Faturimi i energjisë dhe i ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e konsumatorit. Gjithashtu gjykata vlerëson se korigjimi i bërë nga paditësi është në kundërshtim edhe me Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017, 13 prill 2017) në nenin 5 par. 1, pika 1.5 që përcakton se: “1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja;” dhe në pikën 1.6. përcakton se: “marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim, që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.”*

Gjithashtu në nenin 28 par. 1, 2 dhe 3 përcaktohet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit kundër Vendimit të DMK-së me të cilin është aprovuar ankesa e konsumatorit A.A, dhe është obliguar KES/CO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR – 90025040 nga korigjimi nr. 87309DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 409.36€ dhe nr. 87310DPR-90025040-90025040 në vlerë prej 2,749.28€, të datës 06.10.2016.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në këtë çështje, por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin relevante me çështjen dhe me ndikim për vendosje ndryshe.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.41/22, datë 03.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.